



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 673, Datë 23.01.2020

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.01.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve.” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.

VËREN SE :

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.

Pala blerëse: Mol Crossroads B.V është një shoqëri me seli ligjore në Amsterdam, Hollandë, e zotëruar tërësisht nga Mol Hungarian Oil and Gas Public Limited Company. Kjo është shoqëria

mëmë në Mol Group, e regjistruar sipas legjislacionit Hungarez dhe aktive në zinxhirin e shoqërive të tregut të naftës së përpunuar dhe gazit natyror.

Mol Group ka aktivitet kryesor: eksplorimin, prodhimin dhe rafinimin e naftës së papërpunuar, furnizimin me produktet e rafinuara të naftës, si me shumicë dhe pakicë, prodhimin dhe tregtimin e lëndëve petrokimike, eksplorimin dhe prodhimin e gazit natyror dhe transmetimin e gazit natyror në Hungari.

Mol Group nuk është prezent në Shqipëri nëpërmjet filialeve të tij por gjeneron të ardhura përmes shoqërive të grupit të tij Ina Group dhe MOL LUB Kft,.

Pala shitëse: Chevron Global Ventures Ltd dhe Chevron BTC Pipeline LTD janë shoqëri të themeluar sipas legjislacionit të ishujve të Bermudës

Asnjë nga shoqëritë shitëse nuk është prezent dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Shoqëria Target: Chevron Khazar Ltd, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të ishujve të Bermudës, e cila është pjesë e Chevron Corporation. Aktiviteti i Chevron Khazar Ltd përfshin operacione në fushën e të naftës në Azerbajxhan.

Chevron Khazar Ltd nuk është prezent dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Vlerësimi i përqendrimit

Më datë 04 Nëntor 2019, midis blerësit Mol Crossroads B.V dhe palës shitëse Chevron Global Ventures Ltd dhe Chevron BTC Pipeline LTD është nënshkruar “Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e kuotave”, të shoqërive Chevron Khazar Ltd; Baku - Tbilisi - Ceyhan Pipeline dhe Btc International Investment Co, me garantues Mol Hungarian Oil and Gas PLC.

Pas implementimit të transaksionit të propozuar, Mol Group nëpërmjet Mol Crossroads B.V do të zotërojë:

- i. 100% të aksioneve të Chevron Global Ventures Ltd;
- ii. 8.63% pjesëmarrje në Baku - Tbilisi - Ceyhan Pipeline
- iii. 8.9% pjesëmarrje në Btc International Investment Co

Kontrolli i qëndrueshëm mbi shoqërinë Chevron Khazar Ltd, është përftim kontrolli nga pala blerëse Mol Crossroads B.V dhe vetëm ky transaksion plotëson kriteret e nenit 10, pika 1 germa b të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Referuar pasqyrave financiare të palëve në marrëveshje, transaksioni plotëson edhe kriteret e përcaktuara në 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Sipas nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionin dhe praktikat më të mira të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit është lënë i hapur dhe përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i vlerësuar është përftimi i kontrollit të Chevron Khazar Ltd nga Mol Crossroads B.V. Mol Crossroads B.V. nuk ka prezencë fizike apo shoqëri të regjistruar por realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet shoqërive të Grupit MOL. Shoqëria target, Chevron Khazar Ltd, nuk ka prezencë fizike apo shoqëri të regjistruar dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të shoqërisë Chevron Khazar Ltd nga shoqëria Mol Crossroads B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS